



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV-të
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 152/14
Prishtinë, më 16.04.2014, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hykmete Bajrami, Albana Fetoshi, Muhamet Musafa, Xhevdet Neziraj, Sevdije Lama dhe Duda Balje.

Mungoi: Hasime Krasniqi.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini dhe Dashurije Canolli.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Driton Gjonbalaj- Drejtor i përgjithshëm i AAC-së, Shipe Krasniqi nga AAC, Raif Preteni – drejtor i ZRRUK dhe Ramiz Krasniqi nga ZRRUK, Alban Sutaj Kryesues nga ANJF, Ramadan Gashi – Drejtor në ANJF, Alexaandra FehLinger dhe Rejhane Zylfijaj nga GIZ, Haxhi Gashi-USAID.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

R e n d i i d i t ë s

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 08.04.2014;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil në Kosovë për vitin 2013;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2013;**
- 5. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas vitin 2013;**
- 6. Shqyrtimi i Propozimeve të Komisionit për Përzgjedhjen e Anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës;**
- 7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-239 për mbrojtjen nga zhurma me amendamentet e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;**
- 8. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime të Grupit Punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Rekomandimet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastruktura, Tregti dhe Industri, lidhur me funksionimin e Agjencive dhe Rregullatorëve të Pavarur që i raportojnë Kuvendit;**
- 9. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja: konstatoj se miratohet rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 08.04.2014

Kryetarja: konstatoj se procesverbali miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil në Kosovë për vitin 2013

Kryetarja: raporti vjetori i AAC për vitin 2013 është hartuar sipas formularëve standard. Raporti pasqyron të dhënat për buxhetin e miratuar dhe shpenzimet sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike, krahasimet me vitin paraprak. Raporti po ashtu përmban të dhëna për të hyrat që ka realizuar ky autoritet. Shpenzimi i buxhetit të këtij institucioni është 93% dhe nuk kemi tejkalime të shpenzimeve në kategoritë ekonomike, mirëpo tejkalimet janë bërë në disa nënkategori ekonomike të mallrave dhe shërbimeve, për të cilat është e nevojshme të jepen sqarime.

Driton Gjonbalaj: prezantoi buxhetin e miratuar për AAC-në në total dhe sipas kategorive ekonomike. Sa i përket shpenzimeve, për paga e mëditje janë shpenzuar 93%, mallra e shërbime 94% dhe shpenzime komunale 73%. Gjatë periudhës raportuese AAC ka mbledhur 1,656,541 euro si të ardhura të dedikuara. AAC deri në mesin e vitit 2013 ka pasur të punësuar 26 punëtor nga 27 sa kanë qenë të lejuar, dhe kjo ka ndikuar që nuk është shpenzuar i gjithë buxheti në paga dhe mëditje. Po ashtu në pjesën e dytë të vitit një punëtorë e kemi pasur në pushim pa pagesë. Në kuadër të shpenzimeve për mallra dhe shërbime, në nënkategorinë shpenzimet e udhëtimit kemi një tejkalim prej 1%. Këto shpenzime kanë të bëjnë me trajnimin e stafit profesional, ndërsa një pjesë e vogël është për menaxhmentin. AAC me krenari ju raporton se ka bashkëpunim me disa shtete të rajonit, të cilave iu ndihmon me ekspertizën dhe inspektorët tanë shkojnë në Shqipëri dhe Maqedoni dhe iu ndihmojnë inspektorëve të këtyre shteteve për auditimet e inspektimet në vendet e tyre. Me Maqedoninë kemi marrëveshje sipas së cilës inspektori i shtetit që shkon atje ia mbulon shpenzimet e shteti pritës, ndërkaq në bazë të marrëveshjes me Shqipërinë shteti që dërgon inspektorin i mbulon shpenzimet dhe kjo ka ndikuar në tejkalimin e shpenzimeve të karburantit për vetura. Shpenzimet për ngrohje kanë ndodhur edhe për faktin se janë ngrohur zyret e sistemimit të zyrtarëve në zyre të reja. Për kategorinë blerjet e tjera, kemi tejkalim prej 23%. Arsyeja e tejkalimit ka të bëjë me amortizim të papalanifikuar, është dashur të blejmë paisje teknologjike e këto nuk i kemi pasur të planifikuara, gjithashtu për një auditim ad hoc që është bërë në Aeroportin e Prishtinës na është dashur ta mbulojmë akomodimin e dy ekspertëve. Kemi pasur një ngritje të shpenzimeve për material higjienike dhe është blerë i tërë materiali i planifikuar. Në kategorinë shpenzime komunale buxheti është shpenzuar prej 73% që kemi pasur një kursim të ndjeshëm për shkak të disa masave të ndërmara nga menagjmenti.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil në Kosovë për vitin 2013.

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Zyrës Rregullore për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2013

Kryetarja: raporti vjetor financiar i ZRRUK për vitin 2013 është hartuar sipas formularëve standard. Nga raporti shifet se buxheti i këtij agjensioni është shpenzuar 95.30% , për paga dhe mëditje 99.61% , për mallra e shërbime 92% , shpenzime komunale 71.10%. Ndërkaq subvencione edhe transfere dhe investime kapitale nuk ka pasur të lejuara. Po ashtu raporti përmban të dhëna edhe për të hyrat e realizuara.

Raif Preteni: prezantoi shkurtimisht buxhetin e miratuar të ZRRUK-së për vitin 2013 në total dhe sipas kategorive ekonomike. Sa i përket shpenzimeve në kategorinë paga e mëditje janë realizuar 99.61%, mallra dhe shërbime 92.0%, shpenzimet komunale 71.10% dhe në total buxhetit është shpenzuar 95.31%. ZRRUK ka mbledhur të hyrat nga taksat vjetore të licencimit të ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit edhe kanalizimit prej 97.97% , apo nga 330,554 euro të planifikuara, janë inkasuar 323,816 euro. Borxhet nga e kaluara presim ti inkasojmë përmes procesit gjyqësor, pasi që kemi iniciuar procedurën gjyqësore për inkasimin e tyre. Gjatë vitit 2013 janë shpëtuara 3 gjopa ndaj 3 kompanive rajonale edhe janë inkasuar 2,460 euro. Nga të hyrat vetanake nuk ka pasur të bartura nga viti 2012 në vitin 2013. Në vitin 2013 në kërkesën e ZRRUK, jemi audituar nga auditori i brendshëm i ministrisë së financave dhe rekomandimet e tyre janë implementuar plotësisht. Gjithashtu në vitin 2013 jemi audituar nga auditori i përgjithshëm, por ende nuk kemi raportin e këtij auditimi.

Kryetarja: pyeti se cilët janë borgjlinjtë më të mëdhej që nuk i kanë kryer obligimet e tyre? Po ashtu më intereson me ditë për faturat e përbashkëta në banesat kolektive, a ka arritur me u ba ndonjë zgjidhje apo ende faturat kalkulohe dhe paguhen për gjithë ndërtesën.

Muhamet Mustafa: pyeti si është trendi i përmirësimit të borgjeve, sepse kompanitë e ujësjellësit nga viti në vit kanë probleme me mbledhjen e fatuarave dhe është me interes të dijmë sa është rritur efikasiteti në mbledhjen e borgjeve në krahasim me vitet e mëparshme?

Raif Preteni: sa i përket mbeturinave, deri sa kjo qështje ka kaluar në kompetencë të ministrisë dhe komunave, ne ndaj borxhlinjëve kemi bërë padi gjyqësore dhe deri më tani ka përfunduar procesi ndaj një kompani dhe në bazë të një memorandumit me atë kërkojnë të paguajnë për çdo muaj 2,400 euro, kurse vendimet e prera nga gjykata janë në proces. Sa i përket kompanive të ujit përpos Kompanisë në Mitrovicë që për 5 muajt e fundit nuk ka pasur mundësi me e pague taksën e licencimit pasi që shkalla e arkëtimit në këtë regjion është vetëm 50%, gjashtë kompanitë tjera duke e përfshi edhe Ibër-lepencin do ti kryjnë obligimet e tyre. Shkalla e arkëtimit të borxhit është 70% dhe krahasuar me vitin 2012 nuk ka pasur lëvizje në nivel të sektorit. Sa i përket faturave në banesat kolektive, faturimi duhet të bëhet në bazë të numrit të banorëve të cilet jetojnë nëpër banesa.

Naser Osmani: pyeti a ka bazë ligjore kjo pagesë që po thoni për kokë të banorit?

Raif Preteni: faturimi për kokë banori ndodhë në banesat kolektive ku ka ujëmatës të përbashkët sepse qytetarët po hezitojnë me vue ujëmatës individual. Në bazë të marrëveshjes që kemi bërë me komunën e Prishtinës, besojë se do të bëhet lista e banorëve dhe ajo do ti dërgohet ujësjellësit rajonal të Prishtinës dhe në bazë të saj do të bëhet faturimi i shpenzimit të ujit në banesa me ujëmatës të përbashkët.

Hykmete Bajrami: theksoi se një pjesë e madhe e ujit humbet në rrjet pa ardhur në ujëmsatës, për shkak sepse është rrjeti shumë i dëmtuar. Pyeti a keni bërë analiza të shprehura në vlera financiare apo vlera monetare sa sa janë humbjet e ujit?

Raif Preteni: në nivel të sektorit në vitin 2012, humbjet e ujit ka qenë 58%, kurse në vitin 2013 është 57% . Në këtë drejtim është një projekt prej Zyrës Zviceriane në këtë vit dikun rreth 13 milion euro, që do të rregullohen gypat, që do të ndikojë në zvogëlimin e humbjeve të ujit.

Hykmete Bajrami: shpesh kompanitë publike që duhet të ofrojnë një shërbim për publikun kufizohen me atë se qfarë rezultati financiar do të ketë në fund të vitit, duke harruar komplet se misioni i tyre parasegjithash është për me ofruë shërbimet për publikun. Po vet kjo shifer 58% e humbjeve teknike e ujit prej prodhimit deri të konsumatori është një shifër shumë shqetësuese.

Raif Preteni: pajtohem se janë shqetsuese humbjet e ujit por pa investime është problem me i rregullue këto humbje dhe përgjegjësinë në këtë drejtim e drejtorëve që i emëron qeveria. Ne si Rregullatorë caktojmë tarifatat dhe standardet, por ne nuk përzihemi në menagjmentin e kompanive të ujësjellësit.

Muhamet Mustafa: një problem të ngashëm me humbjet e kemi edhe të energjia, dhe po bisedohet me logjikën se nëse ne i evitojmë humbjet teknike është më keq për konsumatorin, e në fakt duke mos i evituar humbjet teknike dhe komerciale edhe te energjia edhe te uji, ne po i humbim resurset. Por unë mëndojë se kjo punë nuk duhet bërë vetëm nga rregullatori apo ndërmarrjet publike, por është problem për shoqërinë sepse uji nëse humbet, ajo as nuk faturohet e as nuk paguhet, nga ana tjetër ne kemi mungesë të ujit.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2013.

5. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas vitin 2013

Kryetarja: Agjencia ka dërguar raportin financiar për vitin 2013 sipas formularëve standard. Buxheti i këtij agjensionit është shpenzuar 96.66% në total.

Alban Sutaj: sqaroi se Agjencia aktualisht mbulon 13 komuna te Kosovës, zyrat e financuara nga buxheti i Kosovës janë 5, por nga projekti i UNDP për avansimin e gjinor ka mbështetur financiarisht në hapjen e 8 zyrave, por që nuk do të i financon më dhe do të duhej të inkorporoheshin në buxhetin e Kosovës. Ne e kemi shpenzuar 96.66% të buxhetit, ku prej tyre në vitin 2013 për avokat i kemi shpenzuar 61,570 euro. Për një zyre për ndihmë juridike falas nevojiten 28,400 euro dhe në total na kushton dikun 228,000 euro dhe mos financimi i tyre nga projekti nënkupton mbylljen e tyre dhe nderprejen e kontratës për 28 të punësuar.

Hykmete Bajrami: prezantuat numrin e lëndëve që kanë kërkuarë ndihmë, desha t'iu pyes a keni arritur t'iu përgjigjeni të gjithave. Sa i përket ndërprerjes së financimit nga ana e UNDP për zyret rajonale për, është dashtur një marrëveshje në mes te UNDP dhe Ministrisë së Drejtësisë, ku në mes tjerash të figurojë që pas ndërprerjes së financimit nga ana e donatorit, është qeveria që merrë përgjegjësinë, sepse donatoret janë të kujdeshmëm në stabilitetin e projektit të tyre që e mbështetin.

Alban Sutaj: sa i përket kërkesave janë 5,686 kërkesa, disa të tyre janë në procedurë, por të tjerat të gjitha kanë marrë përgjigje. UNDP nuk ka pas marrëveshje me Ministrinë e Drejtësisë, sepse UNDP që nga themelimi e ka përkrahur agjencinë për ndihmë juridike falas dhe me agjencinë ka pas një marrëveshje edhe për zyret rajonale.

Kryetarja: keni bërë pak tejkalime të buxhetit të shpenzimet e udhëtimit për 4% , për blerje tjera të mallra dhe shërbime i keni tejkaluar 35%, mirëmbajtja e riparimi i mjeteve 20%, për qiranë për ndërtesën 9%, një sqarim për këto tejkalime.

Ramadan Gashi: tejkalimet konsiderojë se janë në suaza të normales dhe nëse e krahasojmë vitin 2012 me 2013 ka avansim në planifikimin edhe shpenzimin e buxhetit, është një barazim më i mirë. Është një kursim në kategorinë komunale. Sa i përket derivateve dhe për qiranë, UNDP nuk ka marrë qiranë për për zyrën e Klllokotit dhe është dashtë qiran e kësaj zyre me e pagu nga buxheti agjencisë.

Hykmete Bajrami: duke ditur problemin që do të krijohet për shkak mosfinancimit të zyreve nga UNDP, do të duhej të kërkojm nga komisioni funksional me pa sa është e nevojshme dhe e dobishme për shoqërinë tonë që të kemi vazhdimësinë e 8 zyrave, se ne shumë shpëjtë do të përballemi me një kërkesë buxhetore nga ana e këtij agjensioni.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2013.

6. Shqyrtimi i Propozimeve të Komisionit për Përzgjedhjen e Anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Kryetarja: sqaroi se propozimi i komisionit për përzgjedhjen e një antari të bordit drejtues fondit të kursimeve pensionale është dërguar në Kuvend bazuar në nenin 4.6 dhe 4.11 të Ligji nr 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës, sipas të cilit Kuvendi emeronë anëtarët e bordit drejtues, bazuar në rekomandimin e komisionit për përzgjedhje pas konsultimit me Qeverinë. Qeveria e ka dërgu opinionin e vet ku ka mbështetur kandidatët e propozuar. Nga CV-të e kandidatëve të propozuar shifet se i plotësojnë kushtet për tu emëruar anëtarë të bordit drejtues për fondit pensional.

Naser Osmani: unë mendoj që komisioni për përzgjedhje ka qenë autoritativ, por ajo që nuk shoh në material është mungesa e poentimit, sepse duhet të kemi një pasqyrë për një rënditje e tyre sipas rezultatit në intervistë.

Kryetarja: sa për sqarim këta kandidatët që janë propozuar duhet të kenë cilësinë e anëtarit për përfaqësimin dhe këshillimin e punëdhënësve dhe nga CV-të shohim se e kanë këtë përvojë, siç e kërkon ligji.

Hykmete Bajrami: unë mendoj se ne si komision nuk duhet të rekomandojmë për asnjërin, ti dërgojmë emrat në Kuvend dhe seanca vendosë, kështu kemi vepruar edhe në rastet kur kemi shqyrtuar kandidatët për emërim në borde të institucioneve tjera. Ne mundemi me kërkue poentimin por prapsepapë, kemi

me pas vështirë të përzgjedhim njërin prej tyre, kjo është hendikep që nuk po i shofim edhe të tjerët që kanë konkuruar.

Kryetarja : pasi që të gjithë kandidatët e propozuar i plotësojnë kushtet, ne nuk e favorizojmë asnjërin dhe të gjithë kandidatët i dërgojmë për votim në Kuvend.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit, të emëroj njërin prej kandidatëve të propozuar nga Komisioni për Përzgjedhje: z. Lekë Zherka, Ardi Shita apo Flamur Keqa, për anëtarë të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale, me votim të fshehtë, me mandate tre vjeçar.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-239 për mbrojtjen nga zhurma me amendamentet e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Kryetarja: projektligji dhe amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas sqarimeve, Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr.04/L-239 për mbrojtjen nga zhurma dhe amendamentet e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

8. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime të Grupit Punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur Rekomandimet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastruktura, Tregti dhe Industri, lidhur me funksionimin e Agjencive dhe Rregullatorëve të Pavarur që i raportojnë Kuvendit

Kryetarja: grupi punues i caktuar nga komisioni ka hartuar raportin me rekomandime për komisionin, që e kemi përpara.

Hykmete Bjarami: si grup punues i kemi analizuar rekomandimet e komisionit për zhvillim ekonomik , nuk e kemi pa të arsyeshme të përkrahim rekomandimin e parë, pasi që me një ligj nuk mund të rregullohen të gjitha qështjet për agjencionet e pavarura, dhe cili agjension është i formuar me një ligj të veçantë. Aspektet e përbashkëta të tyre janë vetëm pagat dhe janë qështjet e raportimit. Sa i përket pagave ne kemi rekomanduar që të rregullohe me ligjin për pagat e funksionarve të lartë publik. Pika 2,3 dhe 4 kanë të bëjnë me qështjen e raportimit dhe kemi rekomanduar që të bashkohen në një pikë, sepse është më e arsyeshme të ketë më pak rekomandime për Kuvendin. Po ashtu me qëllim që të kemi më pak rekomandime, kemi rekomanduar që pika 5,6 dhe 7 të bashkohen në një pikë, pasi që rregullojnë të njëjtën qështje dhe në fund të pikës 5, kemi rekomanduar që data 31 mars të ndryshohet në 31 maj. Sa i përket pikës 8, në rast se themelohet një Drejtori apo Zyrë ndërlidhëse në kuadër të Kuvendit, është e nevojshme të dihen detyrat dhe përgjegjësitë e saj. Sa i përket qështjes së shqyrtimit të raporteve financiare, ne kemi bërë tri propozime. Propozimi i parë është që raportet financiare të shqyrtohen nga komisionet funksionale së bashku me raportin e punës. Propozimi i dytë të kalojnë në komisionin për mbikëqyrjen e financave publike dhe propozimi tretë të mbesin siç janë, por se Komisioni për Buxhet

dhe Financa të mos i shqyrtojë ato, pa u shqyrtuar raportet e auditimit. Gjithashtu ne kemi rekomanduar që të gjitha kërkesat buxhtore e institucioneve të pavarura të bëhen në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike. Si dhe rekomandimi i fundit që Kuvendi të caktojë një grup punues të përbërë nga anëtarë të të gjitha komisioneve, në mënyrë që harmonizojmë qëndrimet dhe të dalim me rekomandime të përbashkëta në Kuvend.

Naser Osmani: sa i përket rekomandimit të komisionit për zhvillim ekonomik, që zyra e auditorit t'iu jep prioritet auditimit të agjensioneve të pavarura, mendoj se nuk qëndron pasi që ne nuk mundemi me ndërhye në punën e auditorit general që ka pavarësi të plotë. Te pika 10 kemi dy qështje, njëra është se raportimet financiare me ligj janë të precizume, deri në qfarë date duhet të raportohet, ndërsa raporti i auditimit nuk është i përcaktuar fare, mundet të jetë në fund vit dhe në mes të viti. Sa i përket shqyrtimit të raporteve financiare, nëse ne lejojmë një buxhet të detalizuar dhe raportohet në një komision tjetër, po me duket që këtu po shkpusim një hallk zingjirorë edhe kemi me pas moskuptime, prandaj raportet financiare duhet të mbesin kompetencë e komisionit për buxhet.

Kryetarja: sa i përket qështjes së shqyrtimit të raporteve financiare kemi diskutuar edhe në mbedhjen tjetër dhe kemi thënë se komisioni për buxhet dhe financa është për qështjet e buxhetit dhe financave dhe shyrton qështjet që kanë të bëjnë me buxhetin dhe financat. Prandja është e dosmosdoshme që përmes këtij komisioni të kalojnë edhe raportet financiare. Komisioni për mbikqyrjen e financave publike ka për obligimë ti shqyrtoj raportet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm dhe e analizon efektivitetin e shfrytëzimit të mjeteve financiare. Sa i përket rekomandimit të parë që ka propozuar grupi punues, pajtohem. Kemi thënë edhe herave tjera, problematika kryesore të këto agjencione është mos nxjerrja e ligjit të funksionarëve të lartë publik. Unë pajtohem me atë çka deputeti Osmani, që nuk mundemi të ndërhyjmë në punën e auditorit.

Muhamet Mustafa: unë mendoj se grupi punues ka evidentuar problemet që i kemi me funksionimin e organizatave të pavarura dhe brenga kryesore është për rritjen e numrit të të punësuarve në sektorin publik edhe ngarkesën buxhetore dhe në mënyrën e saj se sa këto organizata mbeten të pavarura. Pajtohem se nuk mundemi të rekomandojmë ligj mbi ligj, po ashtu auditorit nuk mundemi ti caktojm obligime për afatin e raportimit. Sa i përket themelimit të Drejtorisë apo Zyrës ndërlidhëse, kjo duhet të analizohet më mirë se nëse shkojmë në këtë formë do të kemi vetëm rritje në numrit të të punësuarve. Ajo qfarë mund të bëjë Kuvendi është të ofrojë një lloj servisi të përbashkët për këto agjencione që kishte me pengë rritjen e të punësuarve në administratë. Pika e 8 është me rëndësi nëse e arrijm ta zbatojmë.

Albana Fetoshi : unë pajtohem me rekomandimin e grupit punues sa i përket rregullimit të pagave me ligjin për funksionarët e lartë publik, po ky ligj ishte dashur të vie sa më shpejtë dhe ndoshta ishte dashur me një afat për procedimin e tij, pasi që gjatë gjithë kësaj legjislature jemi duke diskutuar për ligjin e funksionarëve të lartë publik dhe ai ende nuk është ardhur. Sa i përket propozimeve që ka bërë grupi punues lidhur me shqyrtimin e raporteve financiare, unë jam për propozimin e tretë që raportet vjetore financiare me i shqyrtu pasi që të shqyrtohen raportet e auditimit të jashtëm nga komisioni tjetër.

Kryetarja : sa i përket pikës 3 që Kuvendi ti shqyrtojë raportet më së voni deri më 31 korrik, me një Abstenim (Albana Fetoshi) të tjerët pajtohen. Po ashtu të gjithë anëtarët pajtohen që në pikën 4 dhe 7 të shtohet fjala “struktura e raportit”.

Muhamet Mustafa: kam problem me konkluzën e pikës 5, Zyra e Auditorit duhet me i dhënë prioritet shpenzuesve më të mëdha të buxhetit, që nuk janë agjencitë e pavarura, por disa ministri.

Kryetarja: konstatoi se të gjithë anëtarët janë pro që të rekomandohet heqja e pikës 5. Sa i përket rekomandimit 8 jam kundër me u formue drejtori e veçantë, por kishte me qenë mirë të jetë një njësi e veçantë me 3 persona edhe me u marr me analiza profesionale dhe të përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e saj, ashtu siç ka rekomanduar edhe grupi punues.

Muhamet Mustafa: faktikisht ne këtu po krijojmë një administratë të re e cila me 3 vet nuk jam i sigurt që ka me e kry punën. Unë mendojë se ne duhet të rekomandojmë që të analizohet mundësia dhe të vlerësohet arsyeshmëria e themelimit të kësaj zyre ndërlidhëse dhe sigurisht të përcaktohen detyra dhe përgjegjësitë e saj nëse duhet të themelohet.

Hykmete Bajrami: zyra është themelim e sipër dhe kemi një punëtor veç të punësuar. Ne mund të rekomandojmë të hiqet pika 8, dhe në rekomandimin e grupit punues të shtohet teksti: Komisioni, po ashtu të shqyrtojë arsyeshmërinë e themelimit të Njesisë për Agjencitë dhe Rregullatorët e Pavarur nga Kuvendi i Kosovës, dhe të përcaktojë detyrat dhe përgjegjësitë e kësaj Njësie.

Kryetarja: konstatoi se të gjithë antëtarët pëtohen që në rekomandimin 10, të fshihen fjalët “dhe Komisioni përkatës për Mbikëqyrjen e Financave Publike”. Në rekomandimin 11, fjala “sanksionimin”, të ndryshohet me fjalën “masat”. Të përkrahet rekomandimi 7 i grupit punues siç është propozuar. Po ashtu të përkrahet edhe rekomandimi 8 i grupit punues me një plotësim, që në fund të tij të shtohet teksti: Komisioni, po ashtu të shqyrtojë arsyeshmërinë e themelimit të Njesisë për Agjencitë dhe Rregullatorët e Pavarur nga Kuvendi i Kosovës, dhe të përcaktojë detyrat dhe përgjegjësitë e kësaj Njësie.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryetarja konstatoi se Komisioni nxori këtë

Rekomandime

- I.** Komisioni për Buxhet dhe Financa, në lidhje me Rekomandimet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastruktura, Tregti dhe Industri, lidhur me funksionimin e Agjencive dhe Rregullatorëve të Pavarur që i raportojnë Kuvendit, rekomandon si në vijim:
 1. Të mos miratohen rekomandimet 1, 5 dhe 8.
 2. Në fillim të rekomandimit 4, fjalët “Raportet e”, të ndryshohen me fjalët “Struktura e Raportit të”. Si dhe në fillim të rekomandimit 7, fjala “Raportit”, të ndryshohet me fjalët “Struktura e Raportit”.
 3. Në rekomandimin 10, të fshihen fjalët “dhe Komisioni përkatës për Mbikëqyrjen e Financave Publike”.
 4. Në rekomandimin 11, fjala “sanksionimin”, të ndryshohet me fjalën “masat”.
- II.** Komisioni për Buxhet dhe Financa, propozon rekomandime shtesë si në vijim:
 5. Përcaktimi dhe harmonizimi i pagave të anëtarëve të Bordeve të Agjencive dhe Rregullatorëve të Pavarur, të rregullohet me Ligjin për pagat e funksionarëve të lartë publik.

6. Agjencitë e Pavarura dhe Rregullatorët obligohen t'i përgadisin kërkesat buxhetore në përputhje me rregullat e përcaktuara në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
7. Kuvendi të formoj një Komision ad hoc të përbërë nga një anëtarë i komisioneve parlamentare, i cili një afat prej tre muajsh, të analizojë dobishmërinë dhe pavarësinë e funksionimit të të gjitha agjencive dhe rregullatorëve të pavarur në raport me koston e tyre dhe t'i sjellë rekomandime Kuvendit për nevojën e ekzistimit të numrit aktual të agjencive dhe rregullatorëve të pavarur. Komisioni, po ashtu të shqyrtojë arsyeshmërinë e themelimit të Njesisë për Agjencitë dhe Rregullatorët e Pavarur nga Kuvendi i Kosovës, dhe të përcaktojë detyrat dhe përgjegjësitë e kësaj Njësie.

Mbledhja përfundoi: 12:50

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj